**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Kuvendi i Komunës**
02 **Nr.** 060/01-39621 **dt.** 16/09/**2026**

Në bazë të nenit 40,43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

**Th ë rr e t**

mbledhjen e **rregullt** të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më **dt: 25.09.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit.
Për shqyrtim në mbledhje propozohet ky rend i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur me dt: 31.08.2026;
2. Propozim Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e pikës I të vendimit 02 Nr.020/04-11325 të datës 30.03.2026 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" Sh.a
4. Propozim vendim për vazhdimin e zbatimit të rendit ekzistues të udhëtimit për operatoret e transportit publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Drenasit, për linjat urbano-periferike.
5. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të përgjithshëm Publik të parcelës nr.391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për punë sociale – Drenas.
6. Raporti i progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025.
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Burim Bujupi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC · OPŠTINA GLLOGOC · GLLOGOC MUNICIPALITY

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr.060/04- 39543 dt. 16 /09 / 2026

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 31.08.2026, e cila filloi në orën 10:35.**

Mbledhjen e kryesoi **Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi,** i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt. Në sallë ishin të pranishëm **26** anëtarë.

**Në mbledhje morën pjesë:** Burim Bujup, kryesues i Kuvendit, Ekrem Elshani (PDKRLL), Naim Gjeli (PDKRLL), Anjeza Kurtaj (PDKRLL), Selman Qallapeku (PDKRLL), Valdet Curri (PDKRLL), Gani Krasniqi (PDKRLL), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Edon Nishori (PDKRLL), Qëndresë Xhema (PDKRLL), Driton Ajazi (PDK), Mërgim Pirraku (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN), Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK) dhe Liman Krasniqi (NISMA).

**Munguan:** Erblinë Morina (PDKRLL).

**Të pranishëm ishin edhe:** Ramiz Lladrovci, kryetar, Arben Shala, nënkryetar, stafi i Zyrës së Kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Burim Bujupi, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit ditës.

**Egzona Tërdevci** tha se, para fillimit të mbledhjes u dakorduam me përfaqësuesit e grupeve kuvendare dhe kryetarin rreth pikës gjashtë. Kërkesa e shumicës prej nesh ishte që ajo të shtyhet si pikë për seancën e radhës, por ju propozuat që të debatohet dhe pastaj të shtyhet votimi.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, ju kërkuat që të shtyhet derisa pala t'ju sjellë fletën poseduese si dëshmi. Unë po them ta hapim debatin, pastaj në debat vendosni dhe vazhdojmë në mbledhjen e radhës. Prona për të cilën po flasim është publike dhe për këtë mbaj përgjegjësi morale, juridike dhe penale për gjithçka.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** theksoi se, para se të fillonte seanca, debati ishte që po e fusim si pikë të rendit të ditës, debatojmë të pika gjashtë.

**Driton Ajazi** tha se, ashtu si u dakorduam, ne jemi të pajtimit që rendi i ditës të kalojë, ndërsa të pika gjashtë të debatojmë dhe t'i paraqesim secili argumentet e veta, pastaj votimin mund ta shtyjmë në një seancë tjetër.

**Arbër Halilaj,** edhe unë mendoj që të gjitha çështjet lidhur me këtë pikë t'i diskutojmë dhe pastaj të vendosim se si do të procedojmë më tutje.

**Me propozimet e dhëna, kryesuesi Buim Bujupi, konstatoi se, më 22 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime u miratua ky:**

## Rend i ditës

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur me 30.07.2026;
2. Propozim-vendim për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Gllogocit për periudhën 2026–2031;
3. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Drenasit;
4. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit;
5. Propozim-vendim për financimin e projektit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS";
6. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas;
7. Raport rreth korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2026;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.
**Pika (1) Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit Komunal të datës 30.07.2026.**
Pasi konstatoi se nuk ka diskutime kryesuesi e hodhi në votim pikën e parë, me 24 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.
**Pika (2) Propozim-vendim për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Gllogocit për periudhën 2026–2031.**

**Egzona Tërdevci,** tha se unë e përgëzoj ekipën që kanë punuar, sepse kanë bërë një dokument të kompletuar. E kam thënë edhe në komitet, ndoshta këtë mundemi me e rregulluar me rregulloren për transport që e diskutuam në punëtori. Është shqetësuese që në Komunën e Drenasit ka transport vetëm deri në orën 18:00, kjo ndoshta nuk rregullohet me planin, por duhet me menduar se si mundemi me e gjetë një zgjidhje që Drenasi me pasë transport edhe pas orës 18:00. E di që komuna nuk ka buxhet me subvencionuar linja, por vetëm me pasë parasysh ekipa që ka punuar në këtë plan edhe ata që kanë me qenë pjesë e rregullores, me menduar për këtë pjesë.

**Xhavit Drenori,** tha se edhe unë ju përgëzoj për punën e mirë që e kanë bërë në këtë plan, por përtej dokumenteve të shkruara mirë, ne duhet të shikojmë situatën si e kemi në terren, në kuptimin që kur të bëhet një dokument, me qenë i zbatueshëm. Kemi disa fshatra që kemi transport publik, shumë njerëz janë të detyruar për shkak të punës me udhëtu për Prishtinë apo Fushë Kosovë dhe janë keq për transport, të cilin komuna shumë lehtë kish mundur të ajo pjesa e transportit të veçantë me gjetur një linjë e cila i mbledh në orën 23:00 – 23:30. Unë e di që buxheti i tyre që punojnë atje nuk është i lartë që me pagu taksi – nuk ia dalin – por edhe pjesën tjetër me e mbuluar ne si komunë, që qytetarët me e ndier dorën e komunës. Unë besoj që me një qasje të mirëkuptimit mundet me u gjete një zgjidhje dhe kërkoj nga drejtoria përkatëse që të bëjë veprimet e saj në kuadër të kësaj kërkese.

**Mehedin Salihu** tha se, ne jemi duke folur për transportin lokal që s'e përfshin Fushë Kosovën, vetëm pjesët e komunës tonë. Deshta me u bërë një pyetje zyrtarëve që e kanë hartuar këtë plan, a janë konsultuar me shoqatën e transportit lokal që i kemi këtu në Drenas, d.m.th. a e kanë marrë mendimin e tyre apo jo, kaq.

**Xhavit Drenori** tha se, e di saktë që është transport publik lokal, sepse dy ditë kemi punuar në punëtori, e që ishte dashur me qenë edhe ti aty me na ndihmu. Unë e di që në Vasilevë nuk ka transport publik, në Shtrubullovë po ashtu nuk ka transport publik lokal dhe ne duhet me gjetë zgjidhje për këta njerëz duke i subvencionuar kompanitë për pjesën tjetër që s'mundet me marrë fitim prej qytetarëve, por me transport të veçantë mund të kalojmë kufirin tonë, me dalë edhe në komunat tjera, pra gjendet një hapësirë ligjore që e lejon një autobus me shku me i marrë ata punëtorë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, sa i përket subvencionimit që e ceki Xhaviti, ne e kemi dorëzuar buxhetin për Kuvend, nëse nuk mendoni me i subvencionu, duhet me mendu edhe ku me i marrë paratë. Unë ju kam treguar se ne nuk kemi mjete për subvencionim. Ju pyetët, Mehedin, a e keni marrë mendimin e operatorëve, ne nuk e kemi marrë mendimin e operatorëve sepse jemi në proces duke draftuar, hartuar rregulloren për transport publik dhe draft-rregullorja e përcakton që duhet me pasur edhe dëgjim publik, jo vetëm të operatorëve, por edhe të qytetarëve tjerë, ndërsa gjithmonë flasim për transport publik brenda territorit të Komunës së Drenasit.

**Afrim Prokshi, shef në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (DSHPE),** u përgjigjet pyetjeve të cekura më lart nga parafolësit, në faqen 45-46 e keni itinerarin e nisjes, ku e kemi planifikuar që nisja prej Drenasit për zonat e caktuara e fundit është në orën 19:00. Në komision e kemi pasur edhe përfaqësuesin e stacionit të autobusëve, ku operojnë të gjithë operatorët ekonomikë që operojnë, ai e ka dhënë një pjesë të kontributit, por shumicën e rasteve nuk ka qenë prezent. Në kuadër të kësaj kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e ministrisë, të cilët punojnë në kuadër të departamentit të rrugëve edhe ata e kanë dhënë kontributin përmes komenteve. Të transporti i veçantë i udhëtarëve, komuna ka të drejtë t'i licencojë operatorët ekonomikë të cilët operojnë në zonat e caktuara, mirëpo ajo duhet të jepet me një marrëveshje ndërmjet dy komunave dhe e miratuar nga ministria, d.m.th. e lejon ligji. Në rregulloren që jemi duke e hartuar do t'i përfshijmë të gjitha gjërat dhe po mundohemi të bëjmë rregullore në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** tha se ne kemi qenë në punëtori treditore dh gjatë këtyre ditëve, bashkë me anëtarët e Kuvendit dhe zyrtarët e komunës, kemi diskutuar për plotësim-ndryshimin e rregulloreve dhe statutit të Komunës dhe kemi bërë punë shumë të mira.

**Mehedin Salihu** tha se, unë e thashë qartë, çdo kilometër që e kalojmë jashtë komunës tonë është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës.

**Liman Krasniqi** theksoi se, unë nuk e përkrahi kërkesën që të subvencionohet transporti jashtë orarit në orët e vona për punëtorë, sepse çdo kompani që angazhon punëtorë jashtë orarit duhet t'ua zgjedhin problemin e transportit dhe nuk është mirë të ngarkohet buxheti i Kuvendit Komunal me këto çështje, ne kemi nevoja për kategori më të domosdoshme për t'i përkrahur.

**Pajtime Berisha,** tha pasi u përmend fshati Vasilevë, deshta me thënë publikisht për këtë çështje – që nuk ka transport fshati Vasilevë – unë këtë çështje e kam ngritur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, për atë arsye dua ta përsëris këtu edhe një herë dhe shpresoj që të bëhet zgjidhje.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** beri të ditur se në punëtori, shqetësimet tona më të mëdha me këtë rregullore kanë qenë vendbanimet e vogla që nuk shkojnë ose nuk aplikojnë me i marrë linjat, prandaj kisha pasur dëshirë që edhe ju, edhe asambleistët tjerë që nuk kanë ardhur, me qenë aty, sepse e shihni që punohet pa politikë, por punohet me bërë dokumente të mira në shërbim të qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës. **Pika (2) Propozim-vendim për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Gllogocit për periudhën 2026–2031.** Për votuan 26, kundër 0, abstenime 0.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e tretë. **Pika (3) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores të punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

**Xhavit Drenori** tha se, unë mendoj që në rregulloren e kuvendit komunal të jetë e përfshirë edhe dikush nga administrata e kuvendit, në këtë rast znj.Liridona Fejza-Ajazi, për shkak se shpesh e kemi vërejtur që, kur kemi pasur paqartësi diku, i jemi drejtuar asaj për të ditur çfarë ka thënë ministria. Unë jam asamblist, nesër mund edhe mos të jem, prandaj personi i parë i qasshëm në këtë rregullore të punës së kuvendit ishte dashur të ishit ju si kryesues, ta keni si bibël dhe kuran, edhe ajo zonja që është në administratë, kurse nga ne, anëtarët e kuvendit, të zgjidhet kush do që ka vullnet, sepse kjo është çështje vullneti e jo ndonjë privilegj shumë i madh, me punuar në këto dy dokumente.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** sqaroi se ky komision përbëhet prej pesë anëtarëve, dy nga ekzekutivi dhe tre nga kuvendi.

**Driton Ajazi,** propozoi Zeqir Hasin si anëtar për plotësim-ndryshim të rregullores së kuvendit.

**Gani Krasniqi**, propozoi Naim Xhelin si anëtar për plotësim-ndryshim të rregullores së kuvendit.

**Egzona Tërdevci** tha se, ne e diskutuam bashkërisht me u përfshi dy rregulloret, jemi të pajtimit meqenëse Arbëri ka punuar shumë, të jetë të pjesa e statutit, e Xhaviti të jetë te pjesa e rregullores, por paraprakisht komisionet me qenë të koordinuara, sepse ndryshimet e prekin njëra-tjetrën, pra neve na duhet.

**Arbër Halilaj** tha se, unë mendoj se secili mund të japë kontribut dhe nuk e kam fare problem a jam të statuti a të rregullorja, unë amandamentimet apo propozimet do t'ia dërgoj komisionit edhe me shkrim, për të pasur më lehtë për t'i shqyrtuar. Kudo që e shihni me të arsyeshme se unë mund të jap kontribut, unë jam i gatshëm.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** prezantoi anëtarët e propozuar për plotësim-ndryshim të rregullores së kuvendit.
**Nga kuvendi:**
1. Xhavit Drenori,
2. Zeqir Hasi ,
3. Naim Xheli.

**Nga ekzekutivi:**
4. Liridona Fejza-Ajazi,
5. Vlora Zuqaku-Morina.
Me këtë përbërje të komisionit, **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** e hodhi në votim pikën e tretë. 26 votuan për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e katër. **Pika (4) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit** edhe ky komision përbëhet prej pesë anëtarëve dy nga ekzekutivi dhe tre nga kuvendi.

**Gani Krasniqi,** propozoi si anëtar për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit Valdet Currin.
**Zeqir Hasi,** propozon si anëtar për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit Driton Ajazin.
**Egzona Tërdevci,** grupi opozitar, propozon si anëtar për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit Arbër Halilajn.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** tha se, propozimet nga ekzekutivi për anëtarë ishin Ruzhdi Lestarni dhe Altina Mulaj-Hajdini.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** prezantoi anëtarët e propozuar për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.
**Nga kuvendi:**
1.Valdet Curri,
2.Driton Ajazi,
3.Arbër Halilaj.

**Nga ekzekutivi:**
1. Ruzhdi Lestarni,
2. Altina Mulaj-Hajdini.

Me këtë përbërje të komisionit, **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** e hodhi në votim pikën e katër. 26 votuan për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e pestë. **Pika (5) Propozim-vendim për financim të projektit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS".**

**Xhavit Drenori** tha se, i falënderojnë shumë për punën që janë duke e bërë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** e hodhi në votim pikën e pestë, e cila kaloi, 26 votuan për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hapi diskutimin për pikën e gjashtë. **Pika (6) Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.**

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, çështja e pikës gjashtë nuk do të duhej të kalonte në debate që x personi pretendon se është prona e tij, do t'i sqarojmë përmes zyrtarëve tanë. Qendrës për Punë Sociale është në një objekt jashtë çdo rrethane për me kry aktivitetin e tyre të punës edhe kanë bërë kërkesë për me kalu në pronën e komunës, të cilën komuna e posedon prej viteve 1982-83-84 dhe e ka në fletët poseduese të saj. Gjatë debatit do të sqaroj për çdo njërin, unë edhe dy zyrtarët që janë këtu, me përgjegjësi të plotë penalo-juridike e morale deklarojmë se askujt me këtë rast nuk ja kemi mohuar e as nuk ja mohojmë të drejtën, përveçse e mbrojmë pronën e patjetërsueshme të Komunës së Drenasit. Në pronën e cila është shpronësuar, neve nuk na intereson a u pagua a nuk është paguar, me të gjitha ligjet, ekzistuese në Kosovë, prona nuk

kthehet në asnjë mënyrë të pronari. Pala ka të drejtë vetëm me vazhdu procedurën brenda afateve ligjore dhe me ndjek të drejtën e vet në qoftë se nuk e ka marrë pagesën ose vlerësimin e duhur.

**Altina Mulaj-Hajdini,** zyrtare ligjore e komunës, e sqaroi paqartësinë për pikën e gjashtë, Propozim-Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas, këto dy parcela, në bazë të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, janë prona komunale. Procedura e inicuar gjyqësore nga pala e kundërt si paditës ka të bëjë me parcelën 391-1, e cila nuk është aspak kontestuese për institucionin. Parcela 391-1 edhe ashtu figuron si pronë në emër të paditësit **Imer Osmanit** dhe çdo të drejtë pronësore për të cilën pretendon pala që e ka për këtë parcelë. Mirëpo, gjatë padisë së tij, e cila me objekt kontesti është vërtetim i pronësisë, i njëjti i referohet të drejtave të tij për 391-1, duke supozuar që gjatë parcelizimit të kësaj parcele e njëjta është parcelizuar në numrin 391-5, e cila po shqyrtohet këtu, që për institucionin tonë është totalisht e pabazuar dhe për këtë pranë institucioneve gjyqësore i kemi paraqitur edhe pretendimet tona, të cilat do t'jua elaboroj.
Fillimisht, parcela para luftës është parcelizuar në disa parcela si 391-1-2-3-4-5-6-7, d.m.th. parcela 391 i ka këta numra nga vitet 1983-84, në kuadër të këtyre numrave që është parcelizuar kjo parcelë, pronësi e jona është 391-2, 391-5, d.m.th. me parcelën 391-1 ne nuk kemi asgjë kontestuese as procedurë gjyqësore. Kontestuese për ne është se pala paditëse i referohet parcelës 391-1 duke pretenduar të drejta pronësore me 391-5. Parcela 391-1, pas parcelizimit edhe azhurimit që ka bërë kërkesën në gjeodezi, ajo ka marrë një numër tjetër 391-16, 391-17, për me pasë të drejta pronësore pala duhet me qenë edhe shkaktimi i dëmit, që në rastin konkret mungon. Ligji për marrëdhëniet detyrimore për periudhën kontestuese i aplikueshëm është ligji i vitit 1978, i cili potencon se kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë të kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Në rastin konkret, nëse pala paditëse i referohet të drejtave pronësore për 391-1, edhe bazohet në një dokument për leje ndërtimi për një objekt, mospërputhshmëria është se këto të drejta pronësore edhe mbi të njëjtin dokument po i kërkon për parcelën 391-5, e cila që nga koha e paraluftës është pronë komunale edhe vazhdon me qenë. Në këtë rast paditësi në asnjë mënyrë nuk ka arritur që ta provojë kërkesëpadinë e tij se prona është pronë në emër të tij e as të drejtën e tij dokumenti mbi bazën e të cilit ai e kërkon, që konsiston mbi bazën e të cilit potencon edhe lirisht mund të theksojmë se kemi të bëjmë edhe me elemente të veprës penale për të deklaruarit e rrejshëm.
Duhet me pasë të qartë se parcela 391-5 ka të bëjë më tepër me shfrytëzim-uzurpim sesa me të drejta pronësore, mirëpo legjislacioni në fuqi, se cilës pale ia jep të drejtën për me i kërku të drejtat e tij të cilat ai i pretendon, ne jemi në proces gjyqësor, i kemi dokumentet, fletët poseduese me të cilat paraqiten të gjitha parcelat që janë pronarë persona fizikë edhe parcelat për të cilat është pronar institucioni ynë komunal. Në rastin konkret, parcela 391-5 dhe 381-1 është pronë e komunës. Parcela 381-1 që nga koha e pasluftës nuk ka pësuar ndryshime, parcela 391-1 është azhuruar edhe kjo parcelë tani është e ndarë në 391-16 dhe 391-17 dhe asesi nuk ka marrë numrin 391-5, kjo është gjendja ekzistuese siç ka qenë edhe para luftës, pronë komunale. Asnjë pronë nuk mundet me u transferuar prej personi fizik, shoqëror ose prej komunës në person fizik pa procedurë të plotë e të rregullt të shpronësimit. Nëse pala ka pasur pakënaqësi diçka me procedurat, e ka pasur të drejtën e ankimit, mbrojtjen e dhunshme e të drejtës së vet e ka humbur. Ndër të tjera, përveç objektit, çështjes kryesore që shqyrtohet, pala e ka humbur të drejtën e çdo

pretendimi rreth kësaj prone duke u bazuar në ligjin për marrëdhënie detyrimore, afatin e përgjithshëm të parashkrimit, d.m.th. i ka vjetërsuar kërkesa për pronën për të cilën i referohet.

**Liman Krasniqi,** bëri pyetje se në bazë, para se me u kriju parcela 391-5, cila parcelë ka qenë.

**Safet Hoxha Shef i Gjeodezisë,** tha se sa i përket pyetjes së z. Krasniqi, parcela 391-0 ka qenë fillimisht që nga planet e viteve të 60-ta. Megjithatë, gjatë viteve të 70-ta dhe 80-ta, ka filluar procedura e ndarjes së parcelave. Gjendja që ne posedojmë tregon se nga parcela 391-0 janë krijuar 7 parcela të reja. Në mesin e këtyre 7 parcelave është edhe ajo që ne menaxhojmë, e cila është pronë komunale, siç është parcela 391-5 që ka një sipërfaqe prej 20 ari. Ndërsa, parcela që posedon pala është parcela 391-1.
Fillimisht, menjëherë pas luftës, këto kanë qenë parcela të paazhuruara në hartat kadastrale, por fatmirësisht fletët poseduese që kemi ne si institucion përgjegjës i Kosovës na kanë shpëtuar dhe e kemi ditur saktësisht se cili pronar sa sipërfaqe ka për parcelat adekuate. Ky fillimisht ka bërë kërkesë për caktimin e parcelës së vet 391-1, ku gjeodeti zyrtar i komunës ka dalë në terren dhe ka bërë përcaktimin e kufijve të parcelës me pajtimin e pronarëve në vitin 2019. Po në këtë vit është bërë edhe azhurnimi i parcelës, dhe prej asaj parcele janë ndarë parcelat 391-16 dhe 391-17. Ai e ka ditur saktësisht se ku ka qenë parcela e tij. Pala pretendon që ka një leje ndërtimore, por lejen ndërtimore e ka për parcelën 391 ku ka bërë ndarjen e parcelës. Ndërsa, vendi ku pretendon se është i ndërtuar objekti është pronë komunale. Ne kemi fletë poseduese për këtë pronë, e cila është shpronësuar para viteve të 80-ta. Nuk e di se çfarë ka të paqartë lidhur me këtë çështje të së drejtës.

**Liman Krasniqi** theksoi se, në vitin 1985 është bërë shpronësimi. E kujt ka qenë ajo pronë para vitit 1985 dhe sa ka qenë afati ligjor. Nëse komuna e ka shpronësuar një pronë, brenda sa viteve ka pasur të drejtë ta shfrytëzojë. Ekziston një ligj që ju duhet të na e shpjegoni. a është ende në fuqi rregulli që nëse Kuvendi Komunal e shpronëson një pronë dhe brenda një afati të caktuar ligjor nuk arrin ta shfrytëzojë, prona i kthehet poseduesit.
Gjithashtu, sa i përket lejes së ndërtimit, për shembull, kjo është e viteve të 70-ta. Kur e krahasoj tani në gjeoportal parcelën që ju konfirmoni se është ndarë, as tani nuk ka rrugë për qasje dhe as atëherë nuk ka pasur. Mbi çfarë baze ligjore i është lëshuar një leje ndërtimi në pjesën e fundit të asaj parcele 391-0 që ju dëshmoni. Ndërkaq, kjo parcela që pretendon tani poseduesi, ku ka edhe objektin e ndërtuar dhe thotë se ka leje ndërtimi, ndodhet afër rrugës. Kërkoj nga zyrtarja ligjore që të na e sqarojë këtë në aspektin juridik.

**Altina Mulaj-Hajdini Zyrtare Ligjore,** sa i përket aspektit juridik, po e ripotencoj se nuk ka asgjë kontestuese për të drejtat pronësore që ka pala. Madje, as pala nuk ka asnjë element me të cilin mund të kundërshtojë procedurat e shpronësimit të atëhershëm. Parcela 391-5 nuk është çështje kontestuese as në gjykatë dhe as këtu para jush. Çështjet e shpronësimit janë të qarta, domethënë është pronë në pronësi komunale. Ajo asnjëherë nuk do të kishte mundur të kalonte në pronësi të komunës përderisa nuk do të kryheshin të gjitha procedurat sipas ligjit të mëhershëm për ekspropriјimin.
Elementi i fundit që mund të ishte kontestues është çështje e pagesës. Për këtë çështje e thashë edhe më herët, nëse ka pasur diçka kontestuese ose nuk kanë mundur të bëjnë marrëveshje sepse pala ka qenë e pakënaqur me vendimin, ajo ka pasur të drejtën e mbrojtjes ligjore, por në rastin

konkret pala nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë. Përveçse pala nuk ka të drejta pronësore, ajo ka humbur edhe të drejtën për të mbrojtur pronën e pretenduar. Parcela 391-5 nuk është kontestuese para gjykatës sa u përket procedurave të shpronësimit apo eksproprijimit. Pala në fjalë pretendon se ka pasur të drejtën e ndërtimit të një objekti në parcelën 391-1, mirëpo supozon që ajo parcelë ka marrë numrin e ri 391-5. Kjo gjë nuk qëndron, pasi siç e cekëm më lart, në vitin 2019 është bërë azhurimi i kësaj parcele me kërkesën e vetë palës.

**Liman Krasniqi** tha se, roblemi është që parcela 391-1 është e viteve të 70-ta, kurse parcela 391-5 është e viteve të 85-ta, si po thoni ju, është parcelë e krijuar më vonë, këtu është problemi. Kuvendi Komunal, kur e ka shpronësuar, e ka pasur afatin ligjor brenda çfarë kohe ka qenë i obligueshëm për atë parcelë, që ia kanë marrë pronarit, ta shfrytëzojë. Nëse nuk e ka shfrytëzuar në aspektin ligjor. Na jepni masat të cilat është dashur të ndërmerren edhe prej Kuvendit Komunal, apo të heqë dorë plotësisht pronari.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** bëri të ditur se çdo pronë që e shpronëson komuna ose qeveria dhe e paguan një herë, nuk mund ta qesë asnjë institucion publik në emër të vet pa i përfunduar të gjitha procedurat. Në aspektin ligjor, kur ta ka marrë pronën shteti për interes publik, a ka ndërtuar a s'ka ndërtuar ka pak rëndësi.

**Safet Hoxha, Shef i Gjeodezisë** tha se, unë e sqarova edhe më herët se parcela 391-0 ka qenë e ndarë, por se a është ndarë në vitet e 70-ta a 80-ta nuk e dimë saktësisht, kemi mungesë të dokumentacionit. Por, ne e kemi gjendjen që u azhurnua në vitet 83-84, prej zeros deri në shtatë, dhe parcela numër 1 në vitin 2019 është parcelizuar, se fillimisht është dashur të bëhet përcaktimi kah i ka kufijtë aktualë, të azhurnohet në kadastër, tani të vazhdojë ndarjen e parcelës. Tani ka vazhduar pala, ka bërë ndarjen e parcelës, 16-shin dhe 17-shin. Parcela 391-5 që nga shpronësimi është pronë komunale dhe nuk është prekur asnjëherë, nuk ka asnjë ndryshim në kadastër dhe mundemi ta verifikojmë që nga vitet e 80-ta e deri më sot është e paprekshme, që ka sipërfaqen e njëjtë, pronësinë e njëjtë, kështu që unë mendoj që pretendimi i palës nuk qëndron.

**Liman Krasniqi** theksoi se, a ka mundësi që 4 anëtarë të Kuvendit, pas mbledhjes, ta caktojnë një takim në Gjeodezi dhe të na i sqaroni gjërat ashtu siç kërkojmë, e mos të debatojmë kaq gjerë se s'po kemi kohë. Sepse rrjedha e këtyre procedurave, prej lejes së ndërtimit derisa është parcelizuar edhe e ka marrë pronën e vet Kuvendi Komunal, mua personalisht më duhet një sqarim me persona profesionalë.

**Xhavit Drenori,** faleminderit për sqarimet e nevojshme që i dhatë. Po i drejtohem Kryetarit që i tha dy gjëra para mikrofonit, para publikut, shumë të rëndësishme. E para, që tha se e mban përgjegjësi ligjore-juridike, që për mua dhe të gjithë këta ka shumë rëndësi. E dyta, për mundësinë që ju ndikon dikush. Po, z. Kryetar, neve na ndikojnë njerëzit, sepse edhe ne, sikurse ju, kemi marrë vota prej qytetarëve dhe secilin prej tyre që më thërret në telefon ose më dërgon një e-mail apo mesazh, unë e trajtoj. Po, ka ardhur në zyrën time dhe e falënderoj shumë qytetarin dhe i kam kërkuar informacione shtesë mbi të cilat unë duhet të vendos a e votoj për a kundër. Pala mi ka dërguar dokumentet që e ka një padi të vitit 2019 dhe kërkesën që i ka shkruar Kryesuesit, që kishte qenë e përfshirë edhe Asambleja këtu.

Është një vërejtje për Kryesuesin, sepse duhet ta shpërndajë një kërkesë e cila vjen në emër të Asamblesë, kishte pasë qenë e udhës ta kemi në e-mail këtë kërkesë. Sido që të jetë, koha ka qenë e shkurtër, po ia lëmë edhe kohës pak. Por, ne gjykatës nuk jemi dhe sot nuk kemi për të vendosur sot a kemi për t'ia dhënë këtë pronë palës apo komunës. Procedura gjyqësore ecën më tutje dhe kurdo që të merret ai vendim prej atyre gjykatësve që po e zvarritin këtë lëndë, ai vendim hypën mbi vendimin tonë, çfarëdo që ta marrim. Përndryshe, me këto letra që i kam, qysh e kam votuar pronën komunale për t'ia marrë atje ku kanë ndërtuar më herët, njëjtë e votoj edhe sot. Pretendimi me një padi që bëhet në gjykatë për mua nuk është i mjaftueshëm, sepse, nëse gjykata do të kishte pasur fakte, do ta kishte marrë një masë sigurie. Se pala e ka pasur, besoj, avokatin të angazhuar për këtë çështje dhe ka mundur të na e lehtësojë neve këtë çështje. Me këto dokumente unë mundem të votoj dhe ta vazhdoj procedurën, sepse është pronë komunale dhe secila pronë komunale që e ka fletën poseduese dhe thotë që po e nxjerrim ne sepse kanë keqpërdorur, unë i gëzohem kësaj qysh i jam gëzuar çdo vendimi tjetër. Sepse, luftën më të madhe politike në këtë Kuvend e kam bërë qysh të sjell barazi, që secili qytetar të jetë i barabartë, qoftë në pronë, qoftë në diçka tjetër. Nëse janë kaluar afatet ligjore, që s'mund ta kthejë ky këtë pronë, atëherë mua më vjen keq prej qytetarit, sepse ne jemi për t'i mbrojtur interesat e tyre, por edhe të drejtën e përgjithshme. E nëse një pronë komunale u lëshua me qira aty që nuk e di sa vite, në pronë komunale, unë mendoj që i ka bërë një dëm komunës tonë. Unë nuk jam gjykatësi dhe nuk po dua ta marr rolin e gjykatësit, por, nëse kemi për të marrë një vendim, faktet janë këto.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** e falënderoj Xhavitin për vërejtjet edhe kritikat, por edhe mbështetjen. Është e vërtetë që ju e keni obligim t'i takoni qytetarët, por edhe t'i sitni informacionet. Pretendimet e palës nuk kanë bazë; ata flasin për një pronë tjetër që ata e kanë të disponueshme, veç po provojnë t'i ndërrojnë numrat mos po bëjmë diçka.Me procedurën tuaj është më e lehtë dhe më e shpejtë të shkohet deri te dhënia në shfrytëzim e Qendrës për Punë Sociale (QPS-së), objektit edhe pronës. Pa ju, i kam edhe nja disa muaj që më duhet t'i shtyj. Nëse një pronë vërtetohet se nuk është paguar, ka për t'u zhvilluar procedura për pagesë, jo për kthim të pronës; nuk kthehet, se ajo është e komunës.

**Xhavit Drenori** tha se, ka raste përafërsisht të ngjashme, në kuptimin që ka pasur procedura gjyqësore për kompensim në atë kohë, janë quajtur në këtë Kuvend Komunal dhe për t'ia kthyer pronën komunës, për të zhvilluar procedura kemi pasur edhe në të kaluarën, jo në këtë legjislaturë, por në të kaluarën. Unë u jam gëzuar gjithmonë, sepse secilën prej tyre që e kam hulumtuar, ajo ka qenë bardh e zi pronë komunale. Pala kur ka ardhur në zyrën time, i kam thënë të më japë faktet, si fletën poseduese dhe dokumentet e tjera, dhe përveç një padie s'ka pasur diçka tjetër. Dhe, nëse avokati i palës nuk ka arritur ta bindë gjykatësin ta bëjë masën e përkohshme, unë po mendoj që është e panevojshme për neve si Kuvend ta presim pafundësisht gjykatën për një pronë e cila nuk ka kontest që është pronë komunale, sepse e kemi fletën poseduese.
Prandaj, ne po besojmë që i ndihmojmë palës nëse sot e marrim këtë vendim, qofsha i gabuar. Se ne gjykatës nuk jemi, i ndihmojmë palës ta shpejtojë procedurën te avokati, t'i thotë gjykatësit merre lëndën time dhe qite gurin diku, dhe besoj që gjykata ka për t'i shpejtuar procedurat, qoftë për masë të përkohshme mos ta lërë të ecë me procedurë, qoftë për ta marrë vendimin përfundimtar. Përndryshe, në qoftë se secila palë sjell padi dhe na dëshmon vetëm që ka padi,

secila palë, kjo për mua nuk është proces kontestues për neve si anëtarë të Kuvendit, se nuk jemi gjykatë, gjykata është mbi ne. Dhe gjykata, kur e merr vendimin, atëherë pala e gëzon çfarëdo vendimi që i kthehet, nuk kam absolutisht asgjë.

**Liman Krasniqi** tha se, unë vetëm kisha kërkuar që mos të barazohet procedura e ekspropriјimit dhe procedura e blerjes nga AKK-ja, sepse janë dy gjëra të kundërta, nuk kanë të bëjnë njëra me tjetrën. Por, unë kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjet e tjera dhe ne të marrim informacione nga drejtoria përkatëse, duke pasur parasysh edhe procedurat e dhënies së lejes në bazë të fletës poseduese që ky zotëriu e dëshmon.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** tha se ti Liman ke dhënë leje dhe i ke jep një afat njëvjeçar lejes. Edhe nuk e ka kryer për një afat, ka pasur mundësi të bëjë edhe një kërkesë për një afat shtesë. Je duke folur për një leje që zyrtarët e shpjeguan: është marrë leja, në gjeoportal i ke kufijtë e pronës ku shihen për kur u dha leja, pra në parcelën X. Krejt materialin jua bëjmë skan edhe jua dërgojmë, sikur që jua dërgova vendimin e Gjykatës Supreme. Sepse ne mund të debatojmë, por prona është e komunës. Objektin që e ka bërë në tokë të komunës, e që ka qenë pronë e tij atë s'e mohon askush, po duam t'ia japim Qendrës për Punë Sociale (QPS-së), që ne mos të shkojmë tjetërkund të investojmë, të harxhojmë për të bërë një objekt tjetër kur e kemi objektin.

**Egzona Tërdevci** theksoi se, e përmendi Xhaviti, po e cek edhe unë, që kur përcillen materialet të ju si kryesues për njoftimin tonë, për neve si Asamble, besoj që minimumi i korrektësisë është ta ndani me ne. E kemi grupin joformal në Viber ose përmes e-mailit zyrtar. Unë i kam marrë materialet ndaras. Kur e kemi për ta marrë materialin edhe e kemi diskutuar në KPF, unë personalisht mendoj që janë dy lokacione më të përshtatshme për QPS-në. Por, po e kuptoj argumentin për të mos investuar te çështja e objektit. Por sot nuk është temë lokacioni i përshtatshëm, por është prona për të cilën veç po diskutojmë.
Tani po e kuptoj pse u aktualizua çështja në vitin 2019 me kërkesën e juaj që e keni bërë për KFOR-in, pastaj pala ka bërë kërkesë për parcelizim. E vlerësoj shumë gatishmërinë e zyrtarëve për të na përcjellë një analogji. Unë nuk jam as gjeodete e as juriste, kisha pasur nevojë që, para se të votoj, ta kem atë analogji, që deri në seancën e radhës ne t'i analizojmë edhe dëshmitë që i sjell komuna, por edhe t'i japim mundësi palës për pronësi. Qysh kam hulumtuar edhe jam konsultuar me zyrtar ligjor, pretendimet për pronësi nuk vjetrohen, nuk parashkruhen si lëndë. Duke pasur parasysh krejt këto dilema, faktin që ne si asambleistë mundemi të marrim një vendim të gabuar, unë kisha kërkuar që kjo çështje, pasi ta shterojmë debatin, të na lihet hapësirë deri në seancën tjetër që ne t'i trajtojmë krejt materialet që i pranojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se,** sa i përket materialit, unë nuk kam e-mail zyrtar prej palës pretenduese, asnjëherë nuk kam pasur. Në punëtori nga disa kolegë këtu e kam dëgjuar që pala pretenduese ka dërguar një kërkesë për këtë pronë. Kërkoj falje se nuk e kam pasur materialin.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** tha se palës pretenduese ia ka dërguar materialin për asamble në Kuvend, e ka protokolluar këtu, edhe mund të vërtetohet me saktësi, por po dua me i thënë Egzonës se nuk ka avokat në Kosovë që nuk e di se prona e shpronësuar nuk i kthehet pronarit në qoftëse nuk është paguar, vërtetohet dhe gjykata zhvillon procedura. Prona është publike e komunës dhe nuk kthehet mbrapsht me asnjë procedurë të aplikueshme në Kosovë. Prandaj është aktgjykimi i Gjykatës Supreme, kjo vlen për krejt gjykatësit që gjykojnë lëndë të natyrës së njëjtë derisa nuk ndryshon, kjo është në fuqi.

**Egzona Tërdevci** tha se, më vjen keq kryesues, për pjesën e materialit që të ngarkova me këtë pjesë, nëse nuk e ke marrë materialin. Por, nëse i keni ditur krejt këto, që prona është e komunës, pse nuk janë ndërmarrë masa kurrë prej komunës ndaj uzurpatorëve, me atë çfarë po thoni ju.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, ta shpjegova para seances që njerëzit kanë ndërtuar në mënyrë të egër në gjithë territorin e komunës tonë, siç e kemi lagjen nën hekurudhë, lagjen e Feronikelit, Drenasin qytetin, Poklekun e Ri, Shtrubullovën, në të cilat me një inspektor të ndërtimit nuk mundesh t'i ndalësh. Prona në komunën tonë nuk është ruajtur askund, por ne po mundohemi t'i realizojmë synimet ngadalë-ngadalë, për të mbrojtur pronën tonë publike.

**Arbër Halilaj** tha se, parimisht jam që të shterret ky lloj debate për çështjen e së cilës po diskutojmë. Gjithmonë jam që çështjet që janë në kontest gjyqësor të argumentohen, të dëgjojmë dhe t'i ballafaqojmë argumentet e dy palëve. I falënderoj zyrtarët komunalë për informatat që na i dhanë. E kam para vetes dokumentin e vitit 77, ku ceket parcela 391-1, ku i është dhënë leja për ndërtim të banesës familjare. Kisha dashur një sqarim nga zyrtarja e shërbimit juridik, edhe një herë sqarim se qysh ndërlidhet kjo parcelë dhe kjo leje me parcelën 391-5, ku është edhe i ndërtuar një objekt familjar. Dhe a do të thotë që nuk ka të bëjë ky aktvendim i vitit 77 me objektin ekzistues në 391-5. Dhe në çfarë forme është bërë, sepse thanë që 391-1 është parcelizuar në 7 numra të tjerë, në çfarë forme është bërë shpronësimi ose kompensimi. Vetëm për parcelën 391-1, ndërmjet këtyre parcelave, 391-5 të jetë vetëm ajo pronë publike. Gjithashtu, a është pjesë e lëndës kontestimore 391-1, ku nuk ka objekt të ndërtuar e që është po ashtu ngjitur me 391-5? Edhe çështja e tretë: a do të thotë që një institucioni si QPS-ja po synojmë t'i bëjmë zgjidhje me një objekt siç u cek këtu, i ndërtuar ilegalisht, dhe a jemi në rregull në këtë aspekt.

**Altina Mulaj** tha se, çështja ka filluar në gjykatë me kërkesë të palës, jo të komunës. Komuna me parcelën 391-1 nuk ka asgjë kontestuese, të drejtat pronësore i takojnë palës në fjalë. Pala e ka bërë padinë për të drejtat pronësore për këtë parcelë, mirëpo ka supozuar që kjo parcelë, kur u parcelizua, e ka marrë numrin 391-5, që me gjendjen ekzistuese në gjeodezi është e kundërta. Parcela 391-0 në vitet e 80-ta është parcelizuar në 7 parcela; parcela 391-5 është pronë komunale, ndërsa parcela 391-1 është parcelizuar edhe ka marrë numra të rinj 16-17. Pra, ndarja u bë me kërkesën e palës paditëse. Në këtë rast mund të ketë edhe elemente të veprës penale për shkak të deklarimit të rrejshëm të palës paditëse, i cili pretendon për të drejtat pronësore që i ka, mirëpo në parcelë në pronë komunale. Pra, deklarimet e palës paditëse me gjendjen ekzistuese të dokumentacioneve në drejtori janë kundërthënëse. Në rastin konkret, kryetari objektin ekzistues nuk po don me e asgjësu, por me e shfrytëzu për interes të përgjithshëm. E dimë se çfarë shërbime ofron QPS-ja dhe e dimë që pjesë e tyre janë edhe fëmijët, dhe objekti aktual nuk i

plotëson kushtet elementare për punë. Për mos me e zvarritur procesin e objektit, është me iu ofruar shërbime sa më cilësore dhe të shpejta, sepse trajtohen çështje shumë të ndjeshme. Sistemi gjyqësor se cilës palë ia jep të drejtën për pretendimet e veta, mirëpo kjo e drejtë e palës me gjendjen ekzistuese në dokumentacion është kundërthënëse dhe vërtetohet se cilën e thojmë ne. Pala, me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore, e ka humbur të drejtën për me e kërkuar një të drejtë të tillë pronësore. Sa i përket lejës ndërtimore për parcelën 391-1, pala ka pasur afat me ndërtu objektin brenda një viti, po pala nuk e ka ndërtuar në atë parcelë. D.m.th. ka humbur të drejtën e shfrytëzimit për objektin për të cilin është dashur me ndërtu, por po pretendon për një parcelë e cila është pronë e komunës.

**Arbër Halilaj** tha se, objekti që është në parcelën 391-5 është ilegal, pa leje, dhe a kemi të drejtë t'i bëjmë zgjidhje QPS-së në një objekt pa leje.

**Altina Mulaj-Hajdini,** zyrtare ligjore theksoi se, për me të dhënë një përgjigje të saktë, më duhet me u konsultuar me dokumentacionin që e ka Drejtoria e Urbanizmit, me i shikuar detajet se a kanë marrë leje kur kanë ndërtuar.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, me dhjetëra objekte, duke përfshirë edhe dy objekte të banimit social, nuk kanë certifikatë të pranimit as leje ndërtimi, sepse atëherë nuk ua kanë dhënë. Ne e dimë që KFOR-i nuk u vendos në një objekt i cili nuk i plotëson kriteret në të gjitha aspektet. Kur të marrim tani, nëse votoni ju, e shpejtoni procedurën; nëse jo, e vononi procedurën. Nga Drejtoria e Urbanizmit del një komision, e konstaton dhe, në qoftë se i plotëson kriteret, drejtoria e pajis me leje ndërtimi dhe i thotë QPS-së që ke kaq kohë për me u vendos aty në objekt.

**Liman Krasniqi** tha se, më vjen keq që pas sa vjetësh duhet të bëj të qartë, kryetar, se objekti që ky thotë se s'kam dhënë leje është se ai zotëriu në atë kohë, nëse nuk e ka rregulluar çështjen e marrjes së pronës në shfrytëzim, e ka 56.8 metra jashtë kontratës që e ka marrë pronën në shfrytëzim, e ka në tokë të komunës, dhe për këtë arsye unë ia kam kthyer përgjigjen negative.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci,** sqaroi unë thashë, dy objekte të banimit social nuk kanë certifikatë të pranimit, edhe kemi problem me uzurpatorë, me ndërmarr masa inspektoriati me i nxjerrë, me i vendosë banorë të tjerë.

**Liman Krasniqi** tha se, asnjë objekt i cili nuk është i pranuar teknikisht, komuna si posedues i tokës edhe investimit që është bërë në emër të komunës ka të drejtë me marrë masa, mos me leju me hy banorët pavarësisht. Sidoqoftë, komuna duhet me reagu në ato objekte ku nuk janë pranuar teknikisht. Sa i përket objektit si në këtë rast, nëse konstatohet që është në tokë të komunës, qysh është fleta poseduese, komuna për hir të vlerës së objektit në krahasim me vlerën e tokës ka të drejtë mos me e rrënu atë objekt, po me e marrë në shfrytëzim të vetin, sepse vlera e objektit është më e madhe se toka ndërtimore.

**Driton Ajazi,** e falënderoi palën pretenduese që ishte prezent, po ashtu edhe dy zyrtarët komunalë që sqaruan në aspektin profesional, sepse ne nuk jemi ekspertë as të gjeodezisë as juristë, po këto argumente le të na sjellin me dëshmi, edhe ne t'i kemi argumentet tona në vendim

kur të votojmë në seancën tjetër, me pas një pasqyrë të qartë mbi bazën e çfarë dokumenti po votojmë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, unë ia dërgova një material dhe, sapo të përfundojë seanca, kopjen e materialit ku e kemi kundërshtuar pretendimin e palës tjetër, bashkë me pretendimet e tij, do t'i skajoj [ose do t'i përmbledh] dhe i keni aty te grupi ynë në Viber.

**Gani Krasniqi,** pasi përshëndeti të pranishmit, tha se pajtohet që të shtyhet dhe të vërtetohen shumë gjëra rreth kësaj çështjeje, dhe të vendoset saktësisht dhe mos të gabojmë kur votojmë për ose kundër.

